Përkufizimi:

Fjala arabe *teuekkul* **?????)** (në shqip domethënë *mbështetje*.

Në terminologjinë fetare *teuekkul* quajmë *mbështetjen e zemrës vetëm në Allahun e Lartësuar*.

Mbështetja sheriatike:

Ky lloj i mbështetjes përfshin tri çështje:

1. Mbështetja e sinqertë dhe e vërtetë në Allahun.

2. Besimi i paluhatshëm në Allahun dhe bindja se çdo çështje është në dorë të Allahut.

3. Marrja e shkaqeve të lejuara.

Llojet e mbështetjes:

1. Mbështetje që është ibadet (????? ?????):

Kjo është mbështetja vetëm në Allahun, i Cili nuk ka ortak.

2. Mbështetje që është shirk (????? ???):

Këtu hyn mbështetja në dikë tjetër pos Allahut në ato gjëra që janë të veçanta për Allahun dhe po ashtu mbështetja e plotë ose e pjesshme në shkaqe.

3. Mbështetje që është autorizim (?????):

Kjo është kur e autorizon një person për ta bërë ndonjë punë në vend tëndin dhe ai ka mundësi ta bëjë atë. Kjo mbështetje është e lejuar.

Phoca PDF

Dallimi ndërmjet mbështetjes dhe autorizimit:

Mbështetja është punë e fshehtë e zemrës, kurse autorizimi është punë e dukshme.

Argumenti për mbështetjen është fjala e Allahut:

??
? ? ? ? ? ??

(**Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!**)[1]

Marrë nga libri "Et-Teuhijd el-mujesser" i autorit Abdullah El-Huvejl

Përktheu: Jusuf Kastrati – Shembulli.com

---

[1]Sureja el-maide, 23.

Phoca PDF